

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Valon Totaj - kryetar i kolegjit, Burim Shala e Limni Sallauka – anëtar të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditësve H.B., A.B.1, A.B.2., A.B.3, A.B.4. dhe A.B.5., që të gjithë nga fshati ... komuna e Gllogocit, të cilët i përfaqëson i autorizuari i tyre av.SH.B. nga Gllogoci, kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve “Dardania” me seli në Prishtinë, për shkak të kompensimit të dëmit, duke vendosur sipas ankesës së të paditurës, të paraqitur kundër aktgjyqimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë – Dega në Gllogoc, C.nr.250/10, të datës 08.07.2015, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 23.07.2018, mori këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e të paditurës Kompania e Sigurimeve “Dardania” me seli në Prishtinë, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë – Dega në Gllogoc, C.nr.250/10, i datës 08.07.2015, **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë, me aktgjykimin e ankimuar C.nr.250/10, të datës 08.07.2015, në pikën I të dispozitivit e ka aprovuar pjesërisht kërkesëpadinë e paditësve: H, A1, A2, A.3, A.4 dhe A.B.5. të gjithë nga fshati ... komuna e Gllogocit dhe e ka detyruar të paditurën Kompaninë e Sigurimeve “Dardania” në Prishtinë, që paditësve t’ua kompensojë shumat si në vijim 1. paditëses H.B., në emër të dhimbjeve shpirtërore për shkak të humbjes së bashkëshortit – SH. B.t, shumën prej 3500 €; në emër të mbajtjes së humbur – rentës për periudhën prej datës 15.11.2010, e gjer me datë 30.04.2015, shumën prej 2913.40 €, kurse nga data 01.05.2015, e tutje derisa të ekzistojnë kushtet ligjore, e paditura është e obliguar që paditëses t’i paguaj shumën mujore prej 132.63 €; 2. paditëses A.B.3, në emër të dhimbjeve shpirtërore për humbjen e babit shumën prej 3500 €, kurse në emër të mbajtjes së humbur shumën prej 1396.92 €; 3. paditëses A.B.2., në emër të dhimbjeve shpirtërore për humbjen e babit shumën prej 3500 €, kurse në emër të mbajtjes së humbur shumën prej 2103.40 €. 4. paditëses A.B.5. në emër të dhimbjeve shpirtërore për humbjen e babaits shumën prej 3500 €, kurse në emër të mbajtjes së humbur shumën prej 2913.69 €. 5. Paditëses A.B.4., në emër të dhimbjeve shpirtërore për humbjen e babit shumën prej 3500 €; 6. paditësit A.B.1, në emër të dhimbjeve shpirtërore për humbjen e babit shumën prej 3500 €. Po ashtu gjykata ka vendosur që në emër të shpenzimeve të varrimit, e paditura solidarisht tua kompensoj paditësve shumën prej 749 €, kurse në emër të ngritjes së lapidarit shumën prej 1120 €, të gjitha këto shuma të miratuara me kamatë ligjore të cilën e paguajnë bankat si për mjetet e deponuara mbi një vit pa destinim të caktuar, duke filluar nga dita e marrjes së aktgjyqimit të datës

08.07.2015, e gjer te pagesa definitive, si dhe që t'ia kompensojë shpenzimet e procedurës paditësve në shumën prej 1253 €, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh, nga dita e marrjes së formës së prerë të aktgjykimit nën kërcënim të përmbarrimit me dhunë. Në pikën II të dispozitivit kërkesëpadia e paditësve e cila ka të bëjë për kompensimin në shumën më të lartë se sa shuma e aprovuar si nën pikën a) dhe b) të dispozitivit të këtij aktgjykimi dhe atë për paditësen H.B., në emër të dhimbjeve shpirtërore shumën prej 3500 € deri në 5000 €, në emër të mbajtjes së humbur shumën prej 2.913.40 € deri në 4.162.42 €, kërkesa e paditëses në emër të rentës së kapitalizuar prej 132.63 € deri në 6.465.58 €, të paditëses A.B.3, në emër të dhimbjeve shpirtërore shumën prej 3500 € deri 5000 €, në emër të mbajtjes së humbur shumën prej 1396.92 €, deri në 1.995.60 €, për A.B.2.n, në emër të dhimbjeve shpirtërore shumën prej 3500 € deri 5000 €, në emër të mbajtjes së humbur shumën prej 2103.40 € e deri në 3.004.44 €, për paditësen A.B.5., në emër të dhimbjeve shpirtërore shumën prej 3500 € deri në 5000 €, në emër të mbajtjes së humbur shumën prej 2913.69 € e deri në 4.162.42 €, për paditësen A.B.4., në emër të dhimbjeve shpirtërore shumën prej 3500 € e deri në 5000 €, për paditësin A.B.1., për dhimbje shpirtërore shumën prej 3500 € e deri në 5000 €, në emër të shpenzimeve të varrimit prej 749 €, e deri 1350 € dhe në emër të ngritjes së lapidarit prej 1120 e deri 1600 €, si dhe kërkesa e paditësit për kompensimin e shpenzimeve në shumën më të lartë se sa shuma e aprovuar, është refuzuar si e pabazuar.

Kundër këtij aktgjykimi e paditura në afat ligjor ka paraqitur ankesë për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, si dhe shpenzimeve të procedurës, me propozim që gjykata e shkallës së dytë ta aprovojë ankesën si të bazuar, ashtu që aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë – Dega në Gllogoc C.nr.250/10, të datës 08.07.2015, ta prishë dhe lëndën ta kthejë në rivendosje konform dispozitave ligjore të nenit 195 pika c) të LPK-së, apo të njëjtin ta ndryshojë ashtu që pjesën e gjykuar ta zvogëlojë dhe të njëjtin aktgjykim ta ndryshojë dhe të gjykojë shumat dukshëm më të ulëta duke u bazuar në nenin 195.1 pika e) të LPK-së.

Paditësit përmes të autorizuarit të tyre kanë paraqitur përgjigje në ankesë me propozim që gjykata e shkallës së dytë ta refuzojë si të pathemeltë ankesën e të paditurës KS “Dardania” Sh.a., me seli në Prishtinë dhe ta vërtetojë aktgjykimin e atakuar C.nr.250/10, të datës 08.07.2015.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar, në mbështetje të dispozitës së nenit 194 dhe 195 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

Ankesa e të paditurës është e **pabazuar**.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësit me datë 31.12.2011, në Gjykatën Themelore në Prishtinë – Dega në Gllogoc, kanë paraqitur padi për shkak të kompensimit të dëmit, me arsye sikurse në padi.

Gjykata e shkallës së parë duke vendosur sipas padisë dhe pas shqyrtimit të provave ka nxjerrë aktgjykimin e atakuar C.nr.250/10, të datës 08.07.2015, me të cilën e ka aprovuar

pjesërisht si të bazuar kërkesëpadinë e paditësve duke vendosur me decidivisht si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar. Në arsyetim të aktgjykimit ka theksuar se në këtë çështje kontestimore në mes të palëve ndërgjyqëse pjesërisht kontestuese ishte baza juridike e kërkesëpadisë dhe lartësia e kërkesëpadisë. Gjykata për vërtetimin e bazës juridike të kërkesëpadisë në cilësi të provës materiale ka administruar raportin hetues me nr. 2010 – AR – 2096, të datës 15.11.2010, me të cilën është vërtetuar se me datën 15.11.2010, ka ndodhur aksidenti i komunikacionit rrugor në vendin – rrugën e cila del nga stacioni i autobusëve në Prishtinë, në kycje të rrugës në drejtim të Mitrovicës, i cili aksident kishte ndodhur rreth orës 19:05 minuta, në mes të automjetit të udhëtarëve – autobusit “Mercedes Benz”, me targa regjistrimi XYZ – KS – XYZ, të cilin e ka drejtuar I.(SH).GJ dhe këmbësori SH. B..B, ku si pasojë e aksidentit lëndime vdekjeprurëse ka pësuar SH. B., këtu i ati i paditësve, përkatësisht bashkëshorti.

Gjykata e shkallës së parë ka theksuar se në cilësi të provës materiale ka administruar ekspertizën e ekspertit të komunikacionit të punuar nga V.D të datës 16.02.2010, me të cilën është konstatuar se deri te aksidenti ka ardhur në radhë të parë për shkak të lëshimeve nga ngasësi i autobusit i cili duke mos u përshtatur kushteve të rrugës natë, dukshmërisë së pa mjaftueshme, godet këmbësorin duke u futur nën rrotë dhe e tërheqë zvarrë 24 m, duke mos e vërejtur atë. Në anën tjetër gjykata e shkallës së parë ka theksuar se sipas mendimit të ekspertit të komunikacionit, aksidentit i ka kontribuar edhe këmbësori i ndjer i cili ka tentuar ta kalojë rrugën në kryqëzim pa vendkalim të këmbësorëve duke mos i'u përshtatur rregullave të komunikacionit dhe duke mos i kushtuar rëndësi automjeteve në rrugë. Duke pasur parasysh konstatimin dhe mendimin e ekspertit të komunikacionit se gjer te aksidenti ka ardhur edhe me kontributin e këmbësorit të ndjerit SH. B., gjykata e shkallës së parë ka aplikuar rregullat mbi ndarjen e përgjegjësisë në proporcion 70 % për fajin e të siguarit të të paditurës (drejtuesit të autobusit) dhe 30 % për fajin e këmbësorit – të ndjerit SH. B.t. Më tutje ka theksuar se paditësit bëjnë pjesë në rrethin e ngushtë të anëtarëve të familjes së të ndjerit ku paditësja H. është bashkëshortja ndërsa paditësi A1. është djali, dhe paditëset A2., A.3, A.4 dhe A.5 janë të bijat e të ndjerit. Gjykata e shkallës së parë konstatoi intensitetin e dhimbjeve shpirtërore dhe zgjatjen e tyre të cilat i gjykoi në kompensim të drejtë në të holla, pavarësisht nga kompensimi i dëmit material. Gjykata e shkallës së parë paditësve në emër të dhimbjeve shpirtërore për shkak të humbjes së bashkëshortit, përkatësisht babait, u caktoi kompensimin si nën pikën I të dispozitivit të aktgjykimit me bindjen se një kompensim i tillë sado kudo paraqet një satisfakcion për paditësit në zbutjen e dhimbjeve shpirtërore për humbjen e bashkëshortit përkatësisht babait, të cilat dhimbje janë të pa llogaritshme dhe të pa kompensueshme, duke vlerësuar se shumata e përcaktuara në shpërblim në të holla mund të zbusin dhimbjen e paditësve dhe në një mënyrë plotësimin e nevojave jetësore për shkak të gjendjes së tyre ekonomike, të krijuar si pasojë e vdekjes së kryefamiljarit të tyre, përkatësisht të ndjerit SH.B.. Gjykata e shkallës së parë gjithashtu theksoi se në bazë të certifikatës ID.nr.620, të datës 21.12.2010, të lëshuar nga Qendra Rajonale për Punësim - Zyra Komunale për Punësim në Glllogoc, është vërtetuar se paditësja H.B., është e pa punë dhe se e njëjta ndodhet në evidencën e të pa punësuarve si e pa kualifikuar.

Lidhur me mënyrën e vendosjes si në pjesën e dytë të aktgjykimit të atakuar, e që ka të bëjë me kërkesën e paditësve për kompensimin në shumën më të lartë se sa shuma e aprovuar si nën pikën I a), të dispozitivit të aktgjykimit të atakuar, e cila ka të bëjë në emër të dhimbjeve shpirtërore dhe mbajtjes së humbur, gjykata këtë pjesë të kërkesës e ka refuzuar si të pabazuar. Sipas vlerësimit të gjykatës së shkallës së parë paditësit po ashtu kanë pësuar edhe dëm material i cili konsiston në shpenzimet e varrimit dhe në ngritjen e lapidarit. Sa i përket shpenzimeve të varrimit gjykata e shkallës së parë ka vendosur në bazë të provave – faturës nr. 1/2010, të datës 22.11.2010, të prezantuar nga paditësit sipas së cilës shihet se shuma e shpenzimeve të varrimit është prej 1.070.00 €, ndërsa sa i përket shpenzimeve që kanë të bëjnë me ngritjen e lapidarit po ashtu gjykata e shkallës së parë ka vendosur në bazë të profaturës nr.12010004, të datës 22.12.2010, sipas së cilës lartësia e ngritjes së lapidarit është në shumën prej 1.600.00€, e që dëshmohet me fotodokumentacionin e prezantuar nga paditësit, për të ndjerin.

Lidhur me bazën juridike të kërkesëpadiisë gjykata i është referuar nenit 154 paragrafi (1), 192 paragrafi (1) dhe (2), 200 paragrafi (1) dhe (2), 201 paragrafi (1) dhe 205 të LMD-së, ndërsa për shpenzimet e procedurës ka vendosur në kuptim të dispozitës së 452.2 të LPK-së.

Gjykata e Apelit nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson se qëndrimi dhe përfundimi juridik i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pikat (b), (g), (j), (k) dhe (m) e LPK-së, dhe e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë, e për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të dispozitës së nenit 194 të LPK-së, e po ashtu nuk është i përfshirë as në shkelje tjera të dispozitave të procedurës kontestimore të cilat i ka pretenduar pala ankuese me ankesë.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të të paditurës se gjykata e shkallës së parë ka bërë shkelje të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 8, 182 pika (n), dhe (o), dhe neni 322 të LPK-së, pasi që e paditura pas pranimit të aktvendimit për përgjigje në padi, vetëm pjesërisht e ka kontestuar bazën juridike dhe lartësinë e ekspertizës nga fakti se edhe i ndjeri SH. B. në masë të caktuar i ka kontribuar shkaktimit të aksidentit. Gjykata e Apeli vlerëson se këto pretendime janë tërësisht të pabazuara për faktin se përgjegjësia e të paditurës dhe e këmbësorit – të ndjerit, është vërtetuar nga ekspertiza e ekspertit të komunikacionit ku është bërë ndarja në proporcion 70 % për fajin e të siguarit të të paditurës (drejtuesit të autobusit) dhe 30 % për fajin e këmbësorit – të ndjerit SH. B.t.

Nuk qëndrojnë pretendimet e të paditurës se aktgjykimi është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2 pika (n) e LPK-së. Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit dispozitivi i aktgjykimit të atakuar është mjaft i qartë, rrjedhimisht edhe i përmbareshëm, e në përputhje të plotë me arsyet e aktgjykimit duke qenë kështu në harmoni logjike dhe juridike dispozitivi me arsyetimin.

Gjykata i ka arsyetuar të gjitha faktet me peshë vendimtare për themelësinë e kërkesëpadiisë, e në lidhshmëri me këtë ka arsyetuar mënyrën se si janë vërtetuar faktet,

përveç atyre jo kontestuese, e gjithashtu edhe mënyrën se si i ka vlerësuar provat për secilin fakt të provuar. Gjykata ka arsyetuar të gjitha rrethanat me peshë përcaktuese duke filluar nga përgjegjësia e të paditurës për kompensimin e dëmit, pastaj rrethanat që lidhen me kategorinë e dëmit dhe rrjedhimisht përfundimin për vëllimin e kërkesës së aprovuar.

Gjykata e Apelit nuk i gjen të themelta as pretendimet ankimore për shkelje nga neni 182 paragrafi 2, pika (o) e LPK-së, me arsyetim së në këtë rast paditëset A.3, A2.dhe A.5 B., gjykata e shkallës së parë pos që ka vendosur t'i kompensojë për dhimbje shpirtërore, ka vendosur t'i kompensojë edhe në emër të fitimit të humbur (mbajtjes) dhe se nuk qendrojnë pretendimet ankimore në lidhje me mos parapamjen e këtyre kompensimeve nga ana e ekspertit të aktuaristikës, sepse me ekspertizën plotësuese të datës 18.05.2015, eksperti aktuar i ka cekur në mënyrë të detajuar dhe për secilën paditëse shumat përkatëse të kompensimit në emër të fitimit të humbur që do t'u takonte atyre.

Nuk është pranuar as pretendimi ankimor i të paditurës për shkelje të dispozitave nga neni 183 të LPK-së, për arsye se gjykata ka vërtetuar të gjitha fakte kontestuese me mjete provuese të përshtatshme dhe për të njëjtat ka dhe edhe arsye bindëse, pasi që nga shkresat e lëndës konstatohet se të gjitha faktet e çështjes, përveç atyre që kanë qenë jo kontestuese, janë provuar me prova përkatëse të cilat janë administruar në një proces të rregullt gjyqësor.

Gjykata e Apelit e ka pranuar në tërësi vlerësimin dhe konstatimin e gjykatës së shkallës së parë lidhur me shkaktarin e aksidentit dhe rrjedhimisht edhe për përgjegjësinë e kompensimit. Në këtë kuptim vlerësimin e dhënë nga gjykata e shkallës së parë për besueshmërinë e ekspertizës së komunikacionit mbi kontributin e pjesëmarrësve të përfshirë në aksident, nga ku ka rezultuar ndarja në proporcion 70 % për fajin e të siguruarit të të paditurës (drejtuesit të autobusit) dhe 30 % për fajin e këmbësorit – të ndjerit SH. B.t, e pranon si të tillë edhe Gjykata e Apelit, për të cilën ky është përfundim i drejtë dhe i pranueshëm.

Gjendja faktike në këtë procedurë është konstatuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë edhe sa i përket pasojave që kanë pësuar paditësit për shkak të aksidentit. Në këtë kuptim vlerësimet që ka dhënë gjykata e shkallës së parë për vlerën provuese dhe besueshmërinë e ekspertizës së komunikacionit dhe ekspertizën e aktuaristikës, janë vlerësime që pranohen edhe nga gjykata ankimore.

Gjykata e Apelit vlerëson se në kuptim të dispozitave materialo-juridike të cilave u është referuar gjykata e shkallës së parë e në përputhje me gjendjen faktike të vërtetuar në këtë procedurë, për kërkesat e aprovuara në shumat sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi, gjykata është e mendimit se të njëjtat janë adekuate, e krejt kjo duke marr parasysh dëmin që i është shkaktuar paditësve dhe se lartësia e shumës së të hollave në emër të kompensimit, do t'i mundësoj të dëmtuarve – këtu paditësve, satisfaksion që ata të jenë në gjendje që deri në një masë, t'i kompensojnë të mirat jo materiale nga të cilat janë privuar, respektivisht atë shkallë të satisfaksionit të cilën ato do ta kishin po qëse të njëjtat nuk do t'i kishin humbur, e kjo duke pas parasysh se paditësit kanë humbur babanë e tyre, përkatësisht bashkëshortin, i cili është anëtarë i ngushtë i familjes, e sidomos kur kihen parasysh përjetimet e dhimbjeve

shpirtërore që kanë përjetuar ato me rastin e humbjes së të atit të tyre, përkatësisht bashkëshortit. Me rastin e vendosjes për kërkesën mbi kompensimin e dëmit jo material, si dhe në lidhje me shumën kompensimit të këtij dëmi, mes tjerash gjykata ka pasur parasysh rëndësinë e shkeljes së të mirës dhe të qëllimit të cili i shërben ky kompensim, e gjithashtu edhe faktin se me të njëjtin të mos u shkoj përshtat synimeve që nuk janë të pajtueshme me natyrën e këtij kompensimi dhe qëllimin e tij shoqëror.

Gjykata e Apelit është rezervuar ta arsyetoj pjesën e refuzuar të kërkesëpadisë sepse e paditura ka interes juridik të shprehur me ankesë në pjesën e aprovuar të kërkesëpadisë, në ndërkohë që paditësit nuk kanë parashtruar ankesë.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës është në përputhje më veprimet e ndërmarra në këtë çështje juridike kontestuese, në përputhje me tarifën për përcaktimin e lartësisë se shpenzimeve dhe në pajtim me dispozita e LPK-së.

Nga arsyet e cekura Gjykata e Apelit, gjeti se gjykata e shkallës së parë në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme ka vendosur në këtë çështje juridike, prandaj në mbështetje të dispozitave nga neni 194, 195 paragrafi 1 pika (d) të LPK-së, u vendosë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË

Ac.nr.4398/15, me datë 23.07.2018

**Kryetari i kolegjit – Gjyqtari
Valon Totaj**